



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Mr. 4047/ Prot  
08.08.22

Nr. 502/1 prot.

Shkodër më 03.8.2022

**LËNDA: Mbi vendimet nr. 45, 46 datë 27.07.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës.**

**KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin”, neni 8, shkronja “a”, kreu III, pika 11 e të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, neni 10/j i Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 24, të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, neni 28, pika 3, shqyrtoi vendimet nr. 45, 46 datë 27.07.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës “Mbi pranimin e Znj.Dila Helmeza dhe Z.Dede Çuni në qendrën rezidenciale për të moshuarit “BESA” Barbullush”.

Prefekti ju sqaron se ky akt nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative, për të cilat Prefekti në zbatim të nenit 8, shkronja “a” e ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar ka detyrim të shprehet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI**  
**Majlinda ANGONI**  
**NË MUNGESË**  
**SEKRETARË PËRÇJITËSHËM**  
**Eëlek KASEMI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KESHILLI BASHKIAK**



**VENDIM**

Nr 45. Date 27 / 07 /2022

**Mbi Pranimin e të moshuarës Zj.Dila Helmeza në Qendren e Përkujdesit Rezidencial për të Moshuarit "BESA", Barbullush**

Mbështetur në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Bazuar ne ligjin nr.121/2016"Per shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë;VKM-në518,date 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror, komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar "Kreu III Pika 13,A); pika 14; pika 17; pika 18; pika 23,a; pika 24; Kreu IV "Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes" pika 58,ç; pika 59;" me propozimin e Sektorit të Shërbimit Social, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të:

**KESHILLI BASHKIAK :**

**VENDOSI**

1-Pranimin e Zj Dila Helmeza me nr ID. E05409060W, në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush, duke i ofruar;

- Strehim
- Ushqim
- Përkujdesje Shëndetësore
- Përkujdesje Social-Psikologjike.

2- Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike, sipas percaktimit të nenit 55, pika 6-të e ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

3- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Shërbimit Social.

**SEKRETARI I KESHILLIT**  
**Ardian ÇELEPLJA**

**KRYETARI I KESHILLIT**  
**MARK BISHA**

Miratuar me... 17 .....vota

Vota pro 17..

Vota kunder .....  
.....

Vota Abstenim .....  
.....

Zbardhur me date 02.08.2022

